



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
VENDIM**

Nr.562, Datë 02.12.2021

**PËR
RENDITJEN E KANDIDATËVE NË PROCEDURËN E NGRITJES
NË DETYRËN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË APELIT TIRANË, PËR
POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME
VENDIMIN NR. 180, DATË 28.05.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 147 dhe 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 86, 97 dhe 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikat 9, 10 dhe 14, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, mbi propozimin e relatorit të çështjes,

V E N D O S I:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 180, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:
 1. Znj. {...};
 2. Znj. {...}
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...}dhe znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR